

PERMBLEDHJE JO TEKNIKE

SHFRYTEZIM I KARRIERES SE ARGJILES , OBJEKTI “ARGJILA BRADASHESH”

(Vendndodhja : Zona Nr. 9/5, Qarku Elbasan)

Shoqeria : “ ALB ENERGY” sh.p.k _____

Prill 2015

PASQYRA E LENDES

1.	PERSHKRIM I SHKURTER I PROJEKTIT TE PROPOZUAR.....	Error! Bookmark not defined.
1.1.	Te pergjithshme.....	2
1.2.	Vendndodhja e projektit.....	2
1.3.	Gjeologjia e Rajonit.....	3
1.4.	Infrastruktura.....	3
2.	PERSHKRIM I SISTEMIT TE SHFRYTEZIMIT QE DO TE APLIKOHET.....	4
2.1.	Pershkrimi i sistemit.....	4
2.2.	Kapaciteti nxjeres.....	5
2.3.	Mbetjet e ngurta (Sterilet).....	5
2.4.	Grafiku i zbulimit dhe prodhimit.....	5
2.5.	Regjimi i punes.....	5
3.	PERSHKRIM I RAJONIT.....	6
3.1.	Gjeografia, relievi, klima, bimesia.....	6
3.2.	Hidrologjia.....	6
4.	MAKINERITE DHE PAJISJET.....	7
4.1.	Furnizimi me energji elektrike.....	7
4.2.	Objekti i marrjes se ujit.....	7
4.3.	Objekte te tjera.....	7
4.4.	Makineri dhe pajisje te karrieres.....	7

1 PERSHKRIM I SHKURTER I PROJEKTIT TE PROPOZUAR

1.1. Te pergjithshme

Projekti i hartuar ka per qellim shqyrtimin e mundesive se shfrytezimit te karrieres se argjiles ne objektin " Argjila Bradashesh", Qarku Elbasan nga Shoqeria "ALB -ENERGY"sh.p.k.

1.2. Vendndodhja e projektit

Objekti "Argjila Bradashesh", gjendet rreth 5 km nga qyteti i Elbasanit, Qarku Elbasan.

Te dhena teknike:

Nr	Objekti	Siperfaqja horizontale e objektit	Trashesia qe mund te shfrytezohet	Volumi I bllokut ne m ³	Koficienti I shfrytezimit te argjiles	Rezervat te argjiles	Rezerva Ne ton 1m ³ =1,6t
1	Bradashesh	10000m ²	50metra	500.000	0.25	125000m ³	200.000t
	Totali					125000m ³	200.000t

Tabela e kordinatave te pikave kufizuse:

Pikat	X	Y
1	4541500	4416300
2	4541700	4416300
3	4541700	4416398
4	4541597	44163503
5	4541705	44163530
6	4541700	4416600
7	4541500	4416600

Siperfaqja e zones: S=0.053 Km².

1.3 Gjeologjia e rajonit

Rajoni ku ndodhet objekti “Argjila” zona minerare Nr-9/5 e publikuar per dhenie leje minerare shfrytezimi ndodhet ne zonen tektonike “Kruja”. Ashtu si ne teresi, rajoni qe po perpilohet kjo pakete, nga pikpamja gjeotektonike, perfaqeson nje strukture sinklinale me dy krahet e saj shtrirje :

Veri perendim - Juglindje me renie veri lindore me kend 12-15°. Argjilat e vendburimit Bradashesh, gjendet në kompleksin shkëmbor ranor të zonës tektonike Jonike me origjinë detare të moshës N_1^{-3t} , me natyre kompakte,ngjyre hiri të erret. Janë argjila polimineralë me mbizotërimin e përzierjeve ilit-montmorilonit, ilit -klorit dhe me pak minerale të tjerë. Janë llogaritur **21 300 000** ton argjila, janë shfrytëzuar 3 300 000 ton.

Gjendja aktuale e rezervave gjeologjike është 18 000 000 ton me përmbajtje: $SiO_2 = 40.23\%$. Argjilat janë shtresore - linzore. Shtrihen në përmasa të mëdha, me trashësi minimale 60 m, trashësi maksimale 120 m dhe trashësia mesatare 80 m. Forma e trupit minerale është shtresore. Kanë teksture deri kokrrizore.


Përbërësit kryesore janë: $SiO_2=40.23\%$, $Al_2O_3=11.4\%$, $CaO=12.8 \%$, $MgO=5.8\%$, etj. Argjilat e vendburimit Bradashesh, gjendet në kompleksin shkëmbor ranor të zonës tektonike Jonike me origjinë detare të moshës N_1^{-3t} , me natyre kompakte,ngjyre hiri të erret. Vendburimi është konturuar nga punimet gjeologjike të kërkim - zbulimit. Perspektiva e këtij vendburimi mbetet e hapur.

1.4 Infrastruktura

Infrastruktura e zonës në përgjithësi është e mire. Rruga eshte e hapur ne kuader te punimeve te kryer nga subjektet te cilat kane shfrytezuar per nje periudhe mbi 40 vjecare kete karriere. Objekti gjate fazes se ndertimit dhe shfrytezimit te tij do te lidhet me nje degezim rruge te re me rugen rurale qe vjen nga Jug-Lindja e objektit. Transporti i materialit nga objekti i shfrytezimit tek perdoruesit do te behet me kamiona 40ton duke perdorur rrugen rurale dhe me pas ate nacionale.

1.5 Pershkrimi i projektit

Projekti i hartuar ka per qellim shqyrtimin e mundesive se shfrytezimit te karrieres se argjiles ne objektin “ Argjila Bradashesh”, Qarku Elbasan nga shoqeria “ALB -ENERGY” sh.p.k. Objekti “Argjila Bradashesh”, gjendet rreth 5 km nga qyteti i Elbasanit, Qarku Elbasan.



2 PERSHKRIM I SISTEMIT TE SHFRYTEZIMIT QE DO TE APLIKOHET

2.1 Pershkrimi i sistemit

Pas llogaritjeve paraprake rezervat gjeologjike dhe te nxjerreshme te ndara perkatesisht sipas shkalleve te shfrytezimit si dhe duke mare ne konsiderate elemente te tjere si: topografine, sasine e rezervave , karakteristikat gjeomekanike te shkembenjve, elementet e shtruarjes dhe koeficientin e zbulimit nga 0.0134 ne 0.028 m³/m³, eshte parashikuar shfrytezimi me karriere i rezervave të llogaritura te objektit. minerale **Nr. 9/5** ka pasuar nje aktivitet shfrytezues prej 40 vjetesh , duke u perdorur si lende e pare per prodhimin e tullave per ndertim. Cilesia jo e mire e produktit si dhe konkurenca e tregut beri qe te nderpritej aktiviteti shfrytezues i ketij objekti. Shfrytezimi do te behet me karriere ne siperfaqe ne prani te ujit i cili eshte ne sheshin e karrieres dhe eshte perdorur per zbutjen e mases argjilore pasi shkeputet nga karriera. Ekziston eksperienca disa vjecare ne shfrytezimin e kesaj karriere si dhe nje staf i kualifikuar teknik ne shfrytezimin e argjilave ne kete objekt.

Shfrytezimi prej shume vitesh i kesaj karriere per interesa publike, prodhimin e materialeve te ndertimit ka bere qe banoret e zones dhe ne pjese e mire e fshatrave rrotull ta njohin profesionin e shfrytezimit te argjilave per tu perdorur si material izolues per impiantin e perpunimit te mbetjeve urbane Elbasan. Ne projekt eshte parashikuar nje radhe dhe drejtimi i tille i shfrytezimi, qe ne kombinim me masat e tjera suplementare te mbushjes, sistemit dhe trajtimit, parandalojne erozionin, shembjen dhe vithisjen e shapateve te karrieres dhe siperfaqes se tokes rreth saj. Ne projektin e shfrytezimit jane percaktuar masa si pjerresite e shesheve te punes, kanalet e ndryshme ne ane te rruges etj te cilat do te mundesojne dekantimin e llumrave te pakta ne ujra brenda kufijve te shfrytezimit . Ne stinen e thate keto dekantime do te ngarkohen dhe transportohen ne vendin e depozitimit te dherave .

Nepermjet gjithë kompleksit te punimeve te kryera, eshte bere i mundur deshifrimi i VB-it si per sa i perket perberjes litologjike, asaj formacionale, moshore, jane llogaritur rezervat e pakos produktive, jane percaktuar kufijte e mbulesave e trashesia e tyre dhe jane marre te dhena per tektoniken dhe hidrogjeologjine. Kur ndryshimi ndermjet dy siperfaqeve kufizuese te bllokut nuk i kalon 40%, eshte perdorur formula: Nepermjet gjithë kompleksit te punimeve te kryera, eshte bere i mundur deshifrimi i VB-it si per sa i perket perberjes litologjike, asaj formacionale, moshore, jane llogaritur rezervat e pakos produktive, jane percaktuar kufijte e mbulesave e trashesia e tyre dhe jane marre te dhena per tektoniken dhe hidrogjeologjine. Rezervat e objektit jane llogaritur me metoden e prerjeve vertikale duke matur siperfaqen ne prerje te pakos produktive ne çdo shkalle, mbasi vendburimi (objekti i kerkuar) parashikohet te shfrytezohet me karriere .Kur ndryshimi ndermjet dy siperfaqeve kufizuese te bllokut nuk i kalon 40%, eshte perdorur formula:

$$V = \frac{S_I + S_{II}}{2} \times L$$

Ndersa, kur ndryshimi i tyre eshte mbi 40%, eshte perdorur formula:

$$V = \frac{S_I + S_{II} + \sqrt{S_I + S_{II}}}{3} \times L$$

2.2 Kapaciteti nxjerres

Prodhimi realizuar nga shfrytezimi i ketij objekti ne zonen e kerkuar do te kete si destinacion perdorimin e tij ne industrine e ndertimit dhe te sistemit rrugor apo elementeve te tjere te infrastruktures te rajonit edhe me gjere dhe do te perdoret si stabilizant ne forme te gureve te prodhuar direkt nga karriera. Per kete arsye, ne varesi te tregut te studiuar dhe te pritshem, subjekti parashikon nje prodhim vjetor prej **10.000m³/vit**.

2.3 Mbetjet e ngurta (sterilet)

Gjate hapjes dhe shfrytezimit te objektit do te kete vetem depozitim paraprak te rreth **5000m³** sterile te cilat do te kthehen ne perfundim te shfrytezimit brenda kufijve te karrieres.

2.4 Graku i zbulimit dhe prodhimit

Sasia e pergjithshme e shfrytezimit te kesaj karriere per 3 vjet aktivitet eshte 30000-35000 m³ dhe parashikohet te realizohet duke filluar qe ne vitin e pare të lejes dhe duke vazhduar progresivisht ne vitet e tjera ne vazhdim. Zbulimi teresor i karrierave parashikohet te perfundoje pas 3 vitesh. Pas ketij viti nese subjekti do te shtyje lejen e shfrytezimit per mbi 1 vite nuk do te kete nevojë te kryeje zbulim te karrieres ose do te kryeje zbulim te pakonsiderueshme te rendit jo me shuem se 800 m³/vit .Ne 4 vitete e lejes se shfrytezimit parashikohet te kryhet zbulimi i plote sipas shkalleve te shfrytezimit. Ne vitin e pare parashikohet te realizohet nje zbulim prej rreth 100m³ dhe nje prodhim prej 10 000 m³. Vellimi i pergjithshem i zbulimit ne te gjitha shkallet parashikohet te jete 500 m³. Vellimi ditor, per vitin e pare , do të jetë 80-100 m³/dite, per vitet e tjera 50-m³/dite.

2.5 Regjimi i punes

Per realizimin e prodhimit te parshikuar karriera do te punoje 12 muaj, 22 dite ne muaj me nje dhe dy nderesa ne dite dhe me 6-7 ore /dite pune. Per vitin e pare te aktivitetit te saj karriera do te punoje me nje intensitet me te larte per realizimin e zbulimit, kryerjen e rruges se hapjes ne pjesen e sipërme te objekteve ,sistemimet e ndryshme dhe te prodhimit. Ne objekt parashikohet te punesohen 6 punonjes, te cilet do te jene te specializuar ne kryerjen e proceseve te ndryshme te punes te karakterit minerar.

2.6 Trajtimi i ujrave

Ujrat e reshjeve do te dekantohen ne gropa brenda zones se shfrytezimit. Rrjedhja e me tejshme e tyre do te behet ne perputhje me rrjedhen natyrale te tyre me ane te nje kanali ne ane te rruges se hapjes deri ne kanalin e rruges se poshteme.

➤ Analizat fiziko-kimike te kampioneve

Analizat fiziko mekanike te kampineve te studjuara tregojne se keta gelqerore kane karakteristikat e meposhteme :

- Lageshtia natyrale 0.061%
- Kapaciteti i lageshtise 0.07%

- Pesha specifike 2.75 gr/cm³.
- Kompaktesia 99.3%
- Poroziteti 5%
- Rezistenca ne shtypje ne gjendje natyrale per 19 kampione te analizuar, rezulton nga 960-984 kg/cm².
- Pesha volumore, 2.6 gr/cm³.
- Qendrueshmeria ne terheqje 120 kg/cm²
- Qendrueshmeria ne prerje, 170 kg/cm²
- Fortesia sipas Protodiakonovit, 9.6 deri 9.8
- Kendi i ferkimit te brendshem ne kampione, φ 56° 20'
- Kendi i ferkimit te brendshem ne matricen shkembore φ 48° deri 51°

Materiali i prodhuar pas seleksinimit te argjiles mund te perdoret si lende e pare per prodhim inertesh, lende ndertimi, çakell, rere e perpunuar, gure themelesh, stabilizant ne shtrimin e rrugeve, material ndertimi . Gjaste shfrytezimit nuk do te perdoren lende plasese.

3 PERSHKRIMI I RAJONIT

3.1 Gjeografia ,Relievi ,Klima ,Bimesia e zones Nr-9/5.

Nga pikpamja gjeografike objekti lokalizohet ne nje terreni kodrinor , duke qene se ben pjese ne zonen kodrinore te vendit tone, eshte terren malor, inderthurur nje bimesi e paket (shkoze). Dimri, pergjithesisht, eshte i ashper dhe me lageshti, kurse vera eshte e nxehte dhe e thate. Kjo zone ka mbi 2500 ore ndriçim dielli ne vit. Muaji me ndriçim me te gjate eshte Korriku me 350 ore, kurse me ndriçimin me te shkurter eshte Dhjetori, me 108 ore. Temperatura mesatare vjetore e ajrit eshte afersisht 13.8 grade celcius. Muaji me temperaturen mesatare me te larte eshte Gushti me 37° grade celcius, kurse ai me temperaturen me te ulet eshte Janari me -5 °celcius. Ne pergjithesi, ndryshimet mujore te temperatures jane graduale. Keto ndryshime jane me te medha kur kemi te bejme me ndryshimin e regjimit te stineve. Ky fenomen ndodh ne periudhat Mars – Prill dhe Tetor – Nentor, kur kemi perkatesisht kalimin nga regjimi dimeror ne ate pranveror dhe nga regjimi vjeshtor ne ate dimeror. Vlera maksimale e temperatures se ajrit ne kete zone, me koeficient sigurie 50%, eshte rreth 37 grade celcius.. Siperfaqja e objektit nuk eshte e mbuluar me pyll, nuk eshte toke bujqesore, mbi te nuk ka vepra arti , argjinatura dhe vepra hidroenergetike.

3.2 Hidrogjeologjia

Duke gjykuar nga topografia e terenit, ndertimi gjeologjik i rajonit, topografia e zones se objektit dhe te dhenat hidrogjeologjike te marra nga punime te tjera te kryera ne terren per qellime te ndryshme gjate kryerjes se punimeve gjeologjike , mund te themi se kushtet hidrogjeologjike jane te thjeshta. Dallohen kryesisht ujra te çarjeve, debiti i te cilave varet nga reshjet atmosferike dhe nuk perben ndonje problem te rendesishem per shfrytezimin e objektit. Nga pikpamja hidrogafike, objekti kufizohet me perrenj apo proska te vogla malore qe kane uje

vetem ne kohe reshjesh. Ne afersi te objektit ekziston nje rezervuar I cili sherben per vaditje si dhe zbutjen e argjiles per tu perdorur ne ndertim. Mineralizimi I ujerave ehte Hidro-karbonat magnezial.

4 MAKINERITE DHE PAJISJET

4.1 Furnizimi me energji elektrike

Gjate punimeve te shfrytezimit jane perdorur makineri dhe pajisje te ndryshme te cilat punojne me energji elektrike. Perkete qellim eziston energjia elektrike ne afersi te zones se shfrytezimit. Lidhja telefonike e objektit me subjektin do te behet me telefona mobile.

4.2 Objekti i marrjes se ujit

Per qellim te perdorimit te ujit gjate punimeve si dhe masave njesore uji do te meret nga rezurvari qe ndodhet brenda zones se shfrytezimit.

4.3 Objekte te tjera

Ne objekt parashikohen te ndertohet disa objekte, te cilati do te sherbejne si magazine dhe ambient per rruajtjen e pjeseve te kembimit.

4.4 Makinerite dhe pajisje e karrieres

Nr	Emertimi i makinerive	Njesi	Sasi
1	Eskavator.	Cope	1
2	Motokompresor 40 m ³ .	Cope	1
3	Mjet per transport te brendeshem.	Cop	1
4	Shuma makineri e pajisje		

Te gjitha investimet e parshikuara do te kryen brenda nje periudhe 3 vjeçare qe ndahet ne dy faza investimesh.

Tabela Nr 17: Grafiku u kryerjes se investiemve ne vite

Nr	Emertimi i investimeve	Vlefte e plote ne leke.	Faza e pare	Faza e dyte	Faza e trete
			Brenda vitit te I	Viti II	Viti III
1	Rruge,ndertim montime etj				
2	Makineri pajisje	8.000.000	300000	3.000000	2.000.000

3	Investimet per instalimin energjie+ uji industrial.				
4	Pajisje orendi,ndertesa sociale				
5	Totali i investimeve	8.000.000	3000.000	3000.000	2.000.000